

VENDIM
Nr. 26, datë 30.3.2018

MBI MOSMARRJEN NË SHQYRTIM TË APLIKIMIT PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME KRUJË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Krujë sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Krujë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 18, datë 5.5.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Krujë”.
- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Krujë me anë të shkresës nr. 413 prot., datë 26.4.2017, ka aplikuar për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.
- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Krujë sh.a. nuk ka shlyer detyrimin e pagesës rregullatore që buron nga kontrata, datë 1.6.2007, mes saj dhe Entit Rregullator të Ujit.
- Dosja e aplikimit u paraqit me mungesa në dokumentacion si “Modeli i aplikimit” dhe “Procesverbali i seancës dëgjimore” dhe u plotësua pjesërisht vetëm pas insistimit të Entit Rregullator të Ujit.
- Edhe pas kërkesave të Entit Rregullator të Ujit, modeli i aplikimit për ndryshimin e tarifave rezultoi të jetë i papërfunduar dhe me të dhëna të pasakta.

Për sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim aplikimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Krujë sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Krujë detyrohet të aplikojë për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura me dokumentacionin dhe të dhënat e plota, brenda datës 30.6.2018, pasi në të kundërt do të zbatohen sanksionet që parashikon ligji në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani